

#INNO4EDU

Titulli i aktivitetit	
Shoku magjik	
Mosha	
Periudha zhvillimore 4 -10 vjeç	
Hapësira / lokacioni	Vlera e karakterit
Kushte shtëpie	Fantazi
Koha e nevojshme për përgatitje	Koha e nevojshme për realizim
20 minuta	20 minuta
Qëllimet	
Të zhvillohet fantazia	
Rezultatet e pritshme	
Fëmija ka fantazi të zhvilluar	
Kahje	
<u>Përgatitje paraprake për aktivitet</u> Përgatitje e materialeve të ndryshme për punë	
<u>Instrukcione/kahje për lojën</u> Fëmija duhet mëvetësishëm të punojë një kukull ose karakter nga materiale të ndryshme, me prerje, ngjitje, vizatim e të ngjashme.	
<u>Aktivitet/lojë</u> Fëmija nxitet të flasë për karakteret magjike të përrallave. Pastaj bisedohet për persiatjet e tij, ai i ndan të gjitha mendimet e veta me të tjerët, çfarë është sekreti, a ka sekrete që nuk i ndan me askënd, a ka ndonjë sekret që e ka ndarë me dikënd, a janë ato reale, joreale e të ngjashme. Pastaj udhëzohet të trillojë ndonjë karakter-shok-magjik (mund të jetë në formë kukulle ose simbol që është interesant për fëmijën, p.sh. Yll magjik) dhe ta punojë me materiale të ndryshme që i ka në shtëpi (lugë druri, kuti të vogël kartoni, pëlhurë, çorape e të ngjashme). Pasi ta punojë fëmija karakterin e vet magjik do t'i japë një emër, duhet që ta ruajë në një	



vend të veçantë të shtëpisë dhe me të t'i ndajë ndjenjat, mendimet dhe sekretet e veta. Në këtë mënyrë fëmija do të ketë mundësi për një ekspresion më të mirë të ndjenjave pozitive dhe tejkalimin e atyre negative.

Shtesa

Materiale

/

- Materiale të ndryshme (lugë druri, kuti e vogël kartoni, pëlhurë, çorape e të ngjashme).
- Gërshërë
- Ngjitës

Aktiviteti është përgatitur nga:

Edukatorë: Sonja Çallovska, Vesna Peceva

Dizajn grafik: Katerina Nikolovska

Lekturë: Jana Mihajlovska

Përkthim: Agim Leka

